

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF  
THE SUPREME COURT  
OF KOSOVO ON KOSOVO  
TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU  
AGENCIJU

**ASC-09-0065**

Në padinë e

1. [REDACTED], Skenderaj

2. [REDACTED], Drenas

3. [REDACTED], KK Lipjan

Ankuesit/Apeluesit

Vs.

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

I Padituri

Rr. Ilir Konushevci, nr.8, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Tapio Vanamo, Kryetar i DHPGJS-së, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, lidhur me apelimet e Ankuesve të paraqitura në lëndën SCEL-09-0005, ndaj aktvendimeve të Trupit Gjykues të datave 17 Shtator dhe 24 Nëntor 2009, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 03 mars 2011, lëshon këtë

**AKTVENDIM**

1. ██████████ refuzohet si i pabazuar.
2. Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykses të DHPGJS-së i datës 17 shtator 2009 në lëndën SCEL-09-0005.
3. Apeli i ██████████ kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 24 nëntor 2009 në lëndën SCEL-09-0005 refuzohet si i papranueshëm.
4. Apeli i ██████████ kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 17 shtator 2009 në lëndën SCEL-09-0005 refuzohet si i papranueshëm.
5. Në rastin e apelit, pika 2 e dispozitivit të aktvendimeve të apeluara hiqet.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 17 shtator 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së ka lëshuar një aktvendim në lëndën SCEL-09-0005, në bazë të cilit ankesa e ██████████ për të hyrë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime është refuzuar si e pa pranueshme për shkak të lëshimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj. Në datën e njëjtë dhe për lëndën e njëjtë është marrë aktvendim tjetër nga Trupi Gjykses me të cilin ankesa e ██████████ për të hyrë në listën në fjalë u refuzua si e pabazuar. Më 24 nëntor 2009 Trupi Gjykses i DHPGJS-së lëshoi një aktvendim me të cilin e vazhdoi edhe për 3 muaj afatin për finalizimin e aktvendimit (neni 67.12 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6).

Më 8 dhjetor 2009, ██████████ e parashtrori një apelim në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së kundër Aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 17 shtator 2009, duke thënë se për shkak të obligimeve familjare dhe krizës

ekonomike ai nuk kishte qenë në rrjedha për ditën e fundit të afatit për ushtrimin e ankesës së tij në kohë. Ai pretendon se kishte kërkuar një avokat që të hartojë shkresën përkatëse dhe ta dorëzonte atë përmes postës.

Më 8 dhjetor 2009 [REDAKTUAR] e parashtrroi një apelim pranë Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së duke thënë se ai jeton në kushte shumë të vështira sociale, se ka një fëmijë të sëmurë dhe se nuk ka pasur të holla për të bërë ankesën në kohë.

Më 18 dhjetor 2009 [REDAKTUAR] e parashtrroi një apelim pranë Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së duke thënë se aktvendimi i Trupit Gjyqësor të DHPGJS-së gabimisht e kishte "pezulluar" lëndën. Ai kërkoj që padia e tij të aprovohet si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi me të cilin shtyhet afati për dhënien e vendimit.

Sa i përket apelimit të [REDAKTUAR], më 7 shtator 2010 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdher me të cilin kërkoj nga Apeluesi që brenda 14 ditësh të dorëzojë:

- përkthimin në gjuhën Angleze, përveç apelimit, të të gjitha parashtresave të bashkangjitura me apelim;
- në pajtim me nenin 60.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, kopjen e aktvendimit kundër të cilit është ushtruar apelimi;
- datën e pranimit të aktvendimit të Trupit Gjyqësor nga ana e apeluesit.

Urdhri është dërguar tek Apeluesi më 14 shtator 2010.

Më 29 shtator 2010, [REDAKTUAR] i është përgjigjur urdhrorit duke cekur se më 12 qershor 2009 kishte dorëzuar apelimin me postë të rregullt por jo rekomandë. Ai kishte lutur Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së që të konsideronte apelimin si të afatshëm. Përveç kësaj, përgjigjes ia ka bashkangjitur përkthimet në gjuhën angleze të një vërtetimi të lëshuar nga Ndërmarrja "[REDAKTUAR]" Prishtinë me të cilin vërtetohet se ai është punëtor i kësaj ndërmarrjeje prej datës 8 maj 1979, një vendimi të datës 1 gusht 2003 mbi

shfrytëzimin e pushimit vjetor, dhe të lutjes së datës 30 korrik 2003 drejtuar Ndërmarrjes [REDACTED]” Prishtinë për lejimin e shfrytëzimit të pushimit vjetor. Ai nuk bashkëngjiti aktvendimin e apeluar.

Më 7 tetor 2010, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së ka lëshuar një urdhër për të Paditurin duke ia dërguar apelimet dhe dokumentet mbështetëse.

Më 10 nëntor 2010, i Padituri ka parashtruar përgjigje në apeline duke kërkuar refuzimin e tyre si të pabazuara. I Padituri argumentoi se [REDACTED] as nuk kishte dorëzuar dëshmi të një ankese të mëparshme përmes avokatit e as nuk ka përmendur arsytet për ushtrimin e ankesës me vonesë. Apeli [REDACTED] ishte gjithashtu i pabazuar.

[REDACTED] as që kishte përmendur në apelin e tij ndonjë arsye për ushtrimin e ankesës pranë Trupit Gjykses të DHPGJS-së pas afatit.

### **Arsyetimi ligjor**

[REDACTED]

Apeli i [REDACTED] është i papranueshëm. Apeluesi nuk e plotësoi apelin siç u kërkuar nga Kolegji i Ankesave pasi që nuk e dorëzoi kopjen e vendimit të apeluar dhe nuk e saktësoi datën e pranimit të tij

Sipas nenit 60.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 në lidhje me nenet 28.2 dhe 58.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, apeli duhet të hedhet poshtë me që nuk i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara me këtë dispozitë.

Ratio legis e nenit 60.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 është që t'i mundësojë Kolegjit të Ankesave që, pa pasur nevojë të kërkojë shkresat e lëndës nga

Trupi Gjykses, të kontrollojë kriteret e pranueshmërisë së një apelimi në shikim të parë dhe që të sigurojë se Apeluesi faktikisht apelon në aktvendimin e "duhur". Prandaj, dispozita nuk është vetëm një barrë e pa kuptim të procedurale, por e ka vendin e vet të duhur brenda kriterëve të pranueshmërisë së një apelimi.

██████████

Apelimi është i pranueshme por i pabazuar. Aktvendimi i apeluar duhej të vërtetohet.

██████████ ka dorëzuar ankesën e tij për lëndën e listës së punëtorëve pranë DHPGJS-së pas afatit ligjor. Trupi Gjykses e refuzoi ankesën si të papranueshme në bazë të nenit 28.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 në pajtim me ligjin.

Neni 10.6 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, e përcakton qartë afatin për ankesë kundër listës përfundimtare të punëtorëve legjitim në 20 ditë pas shpalljes së përfundimtare në media nga Agjencia. ██████████ nuk i është përmbajtur këtij afati dhe nuk ka dhënë ndonjë arsye të justifikueshme në kuptim të nenit 117 paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77, 36/80, 69/82, "LPK"; për zbatueshmërinë e tij përmes nenit 70.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 shih ASC-09-0103 et al.) sepse kishte humbur afatin. Arsyet se nuk kishte para për të paguar avokatin nuk mund të pranohet si të justifikueshme pasi që nuk është e nevojshme të ngarkohet avokati për paraqitje të ankesës. Ankuesi do të mund ta kishte bërë këtë vetë. Gjithashtu, arsyet e fëmijës së sëmurë dhe gjendjes së vështirë sociale nuk mund të pranohen si të justifikueshme për humbjen e afatit. Prandaj, trupi Gjykses saktësisht e ka refuzuar ankesën si të papranueshme dhe apelimi duhet të refuzohet si i pabazuar, ndërsa aktvendimi i apeluar duhet të vërtetohet.

[REDACTED]

Ankimi i [REDACTED] është i papranueshëm.

Apelimi mund të jetë e pranueshme nëse ka bazë ligjore dhe faktike për Apeluesin, e cila del nga aktvendimi i atakuar. Ky mund të jetë vetëm fakti nëse aktvendimi i kundërshtuar ka ndonjë efekt ligjor. Aktvendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 05 nëntor 2009 i mungon ky efekt ligjor.

Neni 67.12 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thotë se aktvendimi (përfundimtar) i Trupit Gjykses për të ashtuquajturën Lëndë e Listës së Punëtorëve duhet të dërgohet tek ankuesi(t) dhe Agjencia në çdo rast jo më vonë se 90 ditë nga data kur ankesa është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit. Dispozita e cituar nuk parasheh pasoja nëse Trupi Gjykses nuk e përmbush atë. Kështu që neni 67.12 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 është lex imperfecta, një dispozitë ligjore nga e cila në rast të shkeljes së saj nuk dalin efekte ligjore. Me fjalë tjera, është vetëm një dispozitë që deklaron rezultat të dëshirueshëm, por jo detyrues, trajtim më të shpejtë të mundshëm të Lëndëve të Listave të Punëtorëve në shkallën e parë – sipas gjendjes faktike të DHPGJS-së lidhur me personelin dhe vëllimit të punës.

Neni 67.12 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 as nuk parashkruan një afat në kuptim të nenit 21.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, pasi që klauzola e dytë e kësaj dispozite sqaron se afatet e parashkruara me ligj në kuptim të kësaj norme janë vetëm afatet e vlefshme për palët, por jo ato të dhëna Gjykatës.

Duke marrë parasysh këtë aktvendimi i kundërshtuar i Trupit Gjykses nuk ka substancë ligjore që do të kishte ndonjë efekt ligjor apo faktik tek Apeluesi. nga përmbajtja Është asgjë tjetër përveç se një njoftim për palët që gjykata nuk është në gjendje të finalizojë procedurën brenda afatit të dëshiruar, të cilit – gabimisht – i është dhënë forma e aktvendimit (ASC-09-0098).

Si rezultat logjik, edhe këshilla juridike e dhënë në aktvendimin e datës 5 nëntor 2009 ishte e gabuar.

### **Këshillë juridike**

Pika 2 e dispozitivit të aktvendimit të apeluara duhet të hiqet në rastin e apelimit, pasi që udhëzimet për të ushtruar apelim, duke cituar ligjin, pa ndonjë liri veprimi nga ana e Gjykatës, janë që të mos merren vendime në diapozitiv. Informacionet e tilla mund të jepen tek arsyet ligjore ose – madje – vetëm të bashkëngjiten në aktvendim.

### *Taksat Gjyqësore*

Në bazë të Rregullave Plotësuese Procedurale të DHPGJS-së në lidhje me Taksat Gjyqësore, procedura në lëndët lidhur me Listat e Punëtorëve me të Drejta legjitime (neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 dhe procedurat përkatëse të apeliemeve) janë parimisht pa pagesë, me përjashtim të taksave gjyqësore sipas nenit 10.27 deri 10.41 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008. Bazuar në këto rregulla procedurale, ankuesit lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore edhe për procedurën ankimore. Kështu që, nuk merret aktvendim për shpenzimet.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së më 3 mars 2011:

Tapio Vanamo, Gjyqtar Kryesues

EULEX

\_\_\_\_\_

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar  
EULEX

---

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar

---

Tobias Lapke, Regjistruer EULEX

---